



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

## KURRIKULA ME ZGJEDHJE

**Lënda: Teknologji**

**Shkalla: VI**

**Klasa: XII**

**Tiranë 2017**



**GRUPI I PUNËS:**

) **EDLIRA SINA-KOORDINATORE PROGRAMI , IZHA**

) **ALQI MUSTAFAI**

) **ROBERT TYTYMCE**

) **PETRINA BLUSHI**

## Përmbajtja e Programit

### I. Hyrje

### II. Korniza konceptuale e programit

1. Qëllimet e arsimit parauniversitar.....
2. Qëllimi i programit të Teknologjisë .....
3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e Teknologjisë .....
4. Lidhja e lëndës Teknologji me temat ndërkurrikulare .....
5. Lidhja e lëndës Teknologji me fushat e tjera kurrikulare .....
6. Kompetencat e lëndës që formohen përmes tematikave të saj .....
6. Koha mësimore për secilën tematikë .....

### III. Përmbajtja e TEKNOLOGJISË për klasën e 12-të

#### SHKALLA E GJASHTË KLASA 12

- 1.1 Tematika: **TEKNOLOGJIA DHE SISTEMET TEKNOLOGJIKE**
- 1.2 Tematika: **KOMUNIKIMI GRAFIK**
- 1.3 Tematika: **MATERIALET TEKNOLOGJIKE**
- 1.4 Tematika: **STRUKTURAT DHE MEKANIZMAT**
- 1.5 Tematika: **TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT**
- 1.6 Tematika: **TEKNOLOGJIA E SHERBIMEVE**

IV. **Udhëzime metodologjike**

V. Udhëzime për vlerësimin

VI. Materiale dhe burime mësimore

**Tabelat dhe digramat**

Digrama 1 Korniza konceptuale e programit.....

Digrama 2 Rezultatet e të nxënit të komptencave kyçe që realizohen .....

Digrama 3 Lidhja ndërmjet fushave të tjera. ....

Digrama 4 Kompetencat dhe tematikat e lëndës. ....

Tabela 1 Kompetencat e fushës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave 22

Tabela 2 Orë të sugjeruara për çdo tematikë ..... 24

## I. Hyrje

Edukimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulit. Në një botë, ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme për të gjithë njerëzit gjatë punës ose kohës së lirë, nxënësit duhet të pajisen me aftësi për t'u përballur me to me vetëbesim. Është po aq e rëndësishme që nxënësit të vlerësojnë dhe kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të kenë kapacitetin për të diskutuar dhe për të bërë gjykime personale mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nëpërmjet edukimit teknologjik, nxënësit shtojnë kompetencën, vetëbesimin, bëhen më me iniciativë dhe zhvillojnë aftësi për të kontrolluar elementet e mjedisit fizik. Këto janë rezultate të pritshme të rëndësishme, të cilat kontribuojnë mjaft në hartimin e një kurrikuli të gjerë dhe të balancuar dhe ilustrojnë faktin që pjesëmarrja në edukimin teknologjik përbën një përvojë të vlefshme shkollimi.

Teknologjia është një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre, duke përdorur materialet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ajo integron aftësitë për zgjidhje problemi dhe ato praktike në prodhimin e produkteve dhe sistemeve të dobishme.

Në mënyrë më specifike, vlera e edukimit teknologjik vjen nga përdorimi i një grupi të gjerë aftësish të nevojshme për projektimin apo prodhimin e një produkti, duke çuar në zhvillimin e kompetencës dhe ndjesisë së mundësive personale për t'i zbatuar këto aftësi. Fitimi i aftësive manipulative (përpunuese) përbën një komponent të rëndësishëm për zhvillimin e kompetencës dhe i ndihmon nxënësit të kenë ndjesinë e kontrollit ndaj mjedisit të tyre fizik.

Arsimi teknologjik, si një fushë e kurrikulës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, zhvillon te nxënësit aftësi për t'u përballur me sfida që lidhen me funksionimin e tyre si qytetarë në këtë mjedis teknologjik. Ai integron njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet e duhura për t'u përshtatur

në mjedisin teknologjik ku jetojmë, për të analizuar, konceptuar dhe përdorur sisteme të ndryshme teknologjike, për zgjidhjen e problemeve teknologjike, për prodhimin apo përpunimin e produkteve, për kryerjen e shërbimeve me mjete teknologjike etj.

Nxënësit, gjithashtu, analizojnë dhe vlerësojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë, individit dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata aftësohen të bëjnë gjykime të drejta mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Programi përqëndrohet mbi veçoritë njohëse, psikologjike e sociale të nxënësve, duke ofruar mundësi të aftësimi teorik dhe praktik të tyre, si dhe në formim të kompetencave të vlefshme për gjatë gjithë jetës. Këto programe janë konceptuar si pararendëse të programeve të arsimit të mesëm të ulët, duke përfshirë në to përvoja praktike, si dhe njohuri në fushën e teknologjisë, të cilat u japin mundësi nxënësve të aftësohen e të jenë të përgatitur për nivelet më të larta arsimore. Përvojat që përftohen nga kjo lëndë mësimore mund të transferohen e përdoren lehtësisht dhe në mënyrë produktive edhe në lëndët e tjera duke mundësuar pasurimin e informacionit teorik dhe të kulturës së përgjithshme.

## II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga nga disa dokumente të tjera zyrtare kurrikulare: **Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar (KK)**, **kurrikula bërthamë (KB)** dhe **plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë (PM)**, të cilat do të shoqërohen me udhëzuesit kurrikularë dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve për zbatimin sa më korrekt të tij.

Si i tillë ky dokument i adresohet:

) **nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të TEKNOLOGJISË, në mënyrë që ai të

- përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri;
- ) **mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
  - ) **prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijës (në këtë rast nxënësi) dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara;
  - ) **hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënës;
  - ) **inspektorit dhe vlerësuesit** për aspekte të ndryshme të procesit të mësimdhënies si edhe të nxënies.


Programi i TEKNOLOGJISË ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të fushës/lëndës**, si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i **temave ndërkurrikulare** nëpërmjet lëndës së TEKNOLOGJISË është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e TEKNOLOGJISË në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet **lidhja e Teknologjisë me fushat e tjera**, në mënyrë që kurrikula e arsimit të mesëm të lartë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi përmban **gjashhtë tematika**, të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe të zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe. Në program paraqitet edhe **koha mësimore për secilën tematikë**.

Përdorimi i **metodologjive efikase në mësimdhënien e teknologjisë** është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program, **vlerësimi i nxënësve** është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënies. Programi nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

Digrama 1 Korniza konceptuale e programit

TEKNOLOGJI





## 1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

*Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.*

Në arsimin parauniversitar nxënësi:

- *kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;*
- *përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;*
- *zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;*
- *zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;*
- *aftëson për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;*
- *aftëson për të nxënë gjatë gjithë jetës;*
- *zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;*
- *përdor teknologjitë e reja.*

.....Në këtë kontekst, nxënësi vlerëson teknologjinë duke marrë një përvojë të gjerë dhe sfiduese, e cila iu mundëson fitimin e një grupi njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike.

## 2. Qëllimi i programit të teknologjisë

Kjo lëndë ka për qëllim të zhvillojë te nxënësi aftësitë për të njohur, eksploruar dhe analizuar sisteme të thjeshta teknologjike, kjo, për të lehtësuar përshtatjen e tyre me mjedisin teknologjik që i rrethon.

Për më tepër, kjo lëndë i ndihmon nxënësit për të planifikuar, projektuar dhe zhvilluar praktikisht mjete, metoda apo procese të thjeshta teknologjike, si dhe për të bërë vlerësimin e produktit përfundimtar.

Aftësitë e përfshira do të zhvillohen në mënyrë progresive, ku nxënësit orientohen në zbatimin e fazave të përcaktuara për zgjidhjen e problemeve të thjeshta teknologjike.

Përfshirja në hulumtimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e veprimtarive apo të produkteve të marra nga situata të përditshme, do të rrisin të kuptuarit dhe zgjojnë interesin e nxënësve për këtë fushë të veprimtarisë njerëzore.

Veprimtaritë teknologjike të nxënësve mbështeten duke përdorur edhe TIK-un në regjistrimin, analizimin dhe paraqitjen e informacionit, në nxitjen e hetimeve, analizimin e provave etj.

Lënda e teknologjisë:

- **kontribuon në një edukim të balancuar**, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t'u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike;
- **krijon mundësi integrimi** për njohuritë dhe shkathtësitë të marra në lëndë të tjera, së bashku me cilësitë për hulumtim dhe mendim reflektiv, për gjetjen e zgjidhjeve me vëmendjen e duhur ndaj çështjeve të shëndetit dhe sigurisë;

- lehtëson zhvillimin e një sërë aftësive të komunikimit, që do t'i nxisin nxënësit të shprehin aftësitë e tyre krijuese në mënyrë praktike dhe me imagjinatë;
- siguron një kontekst të gjerë, në të cilin nxënësit mund të zbulojnë dhe vlerësojnë ndikimin e teknologjive në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedisin përreth.

### 3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e teknologjisë

Termi “kompetencë” i referohet një niveli të caktuar të njohurive dhe aftësive që mundësojnë dikë për të vepruar në një shumëllojshmëri të gjerë të situatave. Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë një procesi mësimor. Kompetenca demonstron nga nxënësi (*njohuri*), bazohet në performancën e tij (*aftësi*) dhe në perspektivën e sjelljes (*qëndrim*).

Të mësuarit e Teknologjisë është i bazuar në **kompetenca**, të cilat fokusohen kryesisht tek eksperiencat psiko-motore të moshës për t'i përcaktuar e zhvilluar ato. Në këtë lëndë janë përcaktuar rezultatet mësimore të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme. Organizimi i mësimit përqendrohet në atë *çfarë duhet të dinë e të bëjnë* nxënësit dhe në atë që duhet të jenë të gatshëm të realizojnë. Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së teknologjisë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë **situatat e të nxënësit**, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme për procesin e të nxënësit. **Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.**

Organizimi i mësimit me bazë kompetencat siguron zhvendosjen e fokusit të nxënies nga përmbajtja lëndore (mësuesi në qendër) në atë që nxënësit kanë nevojë të dinë dhe të realizojnë në situata të ndryshme (nxënësi në qendër). Kur nxënësi realizon kompetencat lëndore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e teknologjisë mësuesi/ja ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
  - zbërthen në rezultate të nxëni për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
  - përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës që synon të arrijë nxënësi;
  - zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
  - përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
  - planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
  - kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e teknologjisë.

) *Tabela 1: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet TEKNOLOGJISË për shkallën e gjashtë*

<i>Nr</i>	<i>Shkalla 6, Klasa XII</i>
	<b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive.</i>
<i>I.2</i>	Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat mësimore ose nga jeta e përditshme.
<i>I.8</i>	Prezanton një projekt kurrikular nga fusha e teknologjisë, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë dhe teknologjinë informative.
	<b>Kompetenca e të menduarit</b> <i>Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.</i>

<i>II.1</i>	Prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.
<i>II.3</i>	Krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, që kërkon zgjidhje në një problem teknologjik, duke u bazuar në njohuritë paraprake, si dhe prezanton procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve.
<i>II.4</i>	Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga teknologjia, duke e zbërthyer hap pas hapi dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
<i>II.6</i>	Gjykon vërtetësinë e zgjidhjes së një problemi dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjykimit të dhënë.
<b>Kompetenca e të nxënit</b> <i>Nxënësi mëson për të nxënë.</i>	
<i>III.1</i>	Demonstron shkathtësi funksionale në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja.
<i>III.3</i>	Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e veprimtarive të përdorura, të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënit për temën apo problemin e caktuar.
<i>III.4</i>	Vërteton saktësinë e planifikimit në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxënit.
<i>III.8</i>	Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.).

	<b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b> <i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.</i>
<b>IV.4</b>	Demonstron shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit, si dhe kohën, risqet dhe buxhetin në dispozicion.
<b>IV.7</b>	Harton një projekt me faza të mirëmenaxhuara (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe duke vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme.
	<b>Kompetenca personale</b> <i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme.</i>
<b>V.6</b>	Gjykon mënyrën e komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri, duke vënë theksin në faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e saj dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërpersonale në mënyrë konstruktive.
	<b>Kompetenca qytetare</b> <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i>
<b>VI.6</b>	Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.
	<b>Kompetenca digjitale</b>

	<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.</i>
<i>VII.2</i>	Përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara.
<i>VII.3</i>	Gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.

#### 4. Lidhja e lëndës teknologji me temat ndërkurrikulare

Teknologjia ndërlidhet me të gjitha fushat e tjera, i plotëson dhe plotësohet nga ato për shkak të natyrës komplekse dhe rëndësisë që ka. Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare do të ndihmojë zhvillimin dhe plotësimin e përmbytjes së lëndës për arritjen e të gjitha kompetencave kyçe të kurrikulës. Temat ndërkurrikulare janë tema me të cilat përballet sot shoqëria dhe në të ardhmen. Teknologjia ka një shumëllojshmëri zbatimesh në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e ndërvarur sepse ajo jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare (*Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale; Zhvillimi i qëndrueshëm; Mjedisi; Ndërvarësia; Bashkëjetesa paqësore*) nxënësi duhet të zgjidhë situata problemore, në mënyrë që të qartësojë dhe të shpjegojë çështje të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave teknologjike me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në rritjen e tij personale duke e ndihmuar atë të gjejë vendin e tij në shoqëri. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin.

## 5. Lidhja e lëndës teknologji me fushat/lëndët e tjera kurrikulare

Lidhja midis fushave të ndryshme kurrikulare po rritet gjithnjë e më shumë dhe kjo jo vetëm prej natyrës kroskurrikulare të njohurive që tashmë sistemi edukativ ofron, por edhe sepse është në interesin e të gjithëve për të të bërë më të mirën për një edukim sa më të mirë të nxënësit, pasi e ndihmon atë të kuptojë, të përforcojë dhe zbatojë në praktikë njohuritë e fituara.

Lënda “TEKNOLOGJISE” përdor njohuritë dhe aftësitë që nxënësit kanë marrë në fushën e shkencave, të shkencave shoqërore, në lëndën e artit pamor, si dhe në lëndën e TIK-ut.

**Diagrami 2. Lidhja e lëndës teknologji me lëndët e tjera kurrikulare**

<b>TEKNOLOGJIA</b>	<b>MATEMATIKA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>) Skicimi dhe njohuri kryesore për komunikimin grafik;</li> <li>) Paraqitja e objekteve me anë të projeksioneve kënddrejta;</li> <li>) Paraqitjet aksonometrike dhe hapjet e sipërfaqeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>) Përdor formulat trigonometrike për marrëdhëniet e brinjëve të trekëndëshit me këndet e tij.</li> </ul>
<b>TEKNOLOGJIA</b>	<b>FIZIKA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>) Vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan vetitë fizike të materialeve teknologjike si përcjellshmëria e nxehtësisë, përcjellshmëria e rrymës elektrike, gjendja fizike e materialeve etj;</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>) Strukturat dhe mekanizmat;</li> <li>) Teknologjia e prodhimit të energjisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon llojin e lëvizjes së trupit, si lëvizjet e njëtrajtshme drejtvizore dhe rrethore, - lëvizjet e ndryshueshme etj duke u nisur nga madhësitë fizike që e karakterizojnë atë;</li> <li>-realizon dallimin ndërmjet energjisë potenciale dhe kinetike;</li> <li>-përdor ligjin e ruajtjes dhe transformimit të energjisë;</li> <li>- shpjegon energjinë e lëngjeve, gazeve dhe ligjet e tyre;</li> <li>- përdor konceptet bazë të termodinamikës;</li> <li>-përshkruan prodhimin e energjisë elektrike termike, bërthamore, bioenergjinë, diellore.</li> </ul>
<b>TEKNOLOGJIA</b>	<b>KIMIA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>) Vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike</li> <li>) Teknologjia prodhimit të energjisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegon vetitë kimike të materialeve teknologjike;</li> <li>- shpjegon mbrojtjen e materialeve nga korrozioni;</li> <li>- shpjegon proceset kimike që ndodhin gjatë elektrolizës;</li> <li>- shpjegon proceset kimike që ndodhin në elementin galvanik;</li> <li>- përshkruan hidrokarburet (kimia organike).</li> </ul>
<b>TEKNOLOGJIA</b>	<b>TIK</b>
Për të gjitha tematikat	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdor programet e teksteve në shkrimin e shënimeve ose eksperimenteve në teknologji;</li> <li>- përdor pajisjen e data-logging për mbledhjen, regjistrimin dhe analizën e të dhënave gjatë eksperimenteve në teknologji;</li> <li>- përdor spreadsheet për të analizuar të dhënat dhe për të parë modelin në një grup të dhënash.</li> </ul>
<b>TEKNOLOGJIA</b>	<b>GJUHË SHQIPE</b>

Për të gjitha tematikat	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezanton duke përdorur lloje të ndryshme të medias, si: elektronike, të folur, të shkruar dhe grafike, në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin shkencor të prezantimit.</li> <li>- Përzgjedh informacionin shkencor në një vëllim të caktuar informacioni të tillë, p.sh.: në një artikull shkencor, në një film artistik apo shkencor.</li> </ul>
<b>TEKNOLOGJIA</b>	<b>GJUHA E HUAJ</b>
Për të gjitha tematikat	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizon dhe interpreton tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit shkencor të fizikës në gjuhë të huaj, si p.sh.: me tematikë nga teknologjia;</li> <li>- Shfrytëzon fjalorin terminologjik bazë të teknologjisë në gjuhë të huaj, duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e TIK.</li> </ul>




Diagrama 2

## 6. Kompetencat teknologjike që formohen përmes tematikave të saj

### QASJA E BAZUAR NË KOMPETENCA

- ) **Aftësitë njohëse:** Përcaktimi i problemeve dhe nevojave njerëzore, vëzhgimi, mbledhja e të dhënave, interpretimi i të dhënave të mbledhura, specifikimi i kërkesave që duhet të përmbushë produkti, zgjidhja e problemeve që lidhen me skicimin e produktit, shqyrtimi dhe vlerësimi i zgjidhjes, krahasimi, dallimi, analiza sipas kriterëve dhe vendimmarrja e duhur.
- ) **Aftësitë praktike:** Matja, markimi, prerja dhe dhënia e formave, bashkimi dhe montimi, ndërtimi dhe përfundimi; organizimi i zinxhirit të aktiviteteve në një sekuencë logjike.
- ) **Aftësitë komunikuese:** Formulimi i ideve gjatë fazës së skicimit dhe në fazën e prezantimit të produktit përfundimtar; përgatitja e skicave, diagramave, modeleve dhe fotografive, si dhe skicat dhe grafikët me anën e kompjuterit.

Lënda e teknologjisë synon të përmbushë 4 katër kompetenca lëndore, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij. Këto kompetenca arrihen nëpërmjet 6 (gjashtë) tematikave kryesore.

#### 1. Komunikimi grafik

Nxënësit lexojnë dhe interpretojnë skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike, si dhe përdorin mënyra të thjeshta të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe paraqitur objekte të thjeshta teknike.

#### 2. Strukturat dhe materialet teknologjike

Nxënësit dallojnë materialet teknologjike të llojeve të ndryshme, përshkruajnë vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike kryesore në sistemet teknologjike të sotme, gjithashtu ata tregojnë llojet tipike të strukturave teknologjike si pjesë e sistemeve teknologjike.

### 3. Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike

Nxënësit analizojnë ndikimin e teknologjisë në veprimtaritë ekonomike, si dhe planifikojnë e realizojnë produkte dhe shërbime të thjeshta, me përdorimin e materialeve, veglave dhe proceseve të thjeshta teknologjike.

### 4. Etika dhe kushtet e sigurta në shkollë dhe jashtë saj

Nxënësit njihen me rreziqet që vijnë nga përdorimi i faqeve të web-it të cilat nuk ofrojnë siguri të lartë për ta dhe nuk publikojnë të dhëna personale që çenojnë sigurinë e tyre personale duke e demonstruar përmes veprimeve nevojën për realizimin e tyre në shtëpi, komunitet dhe shkollë sipas rregullave të sigurta.

*Digrama 3; Kompetencat e lëndës*




Tabela 2; Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre

Kompetencat e lëndës:	Përshkrimi i kompetencave
<b>1.Komunikimi grafik</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>) Interpreton skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike.</li> <li>) Përdor mënyra të thjeshta të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe objekte të thjeshta teknike.</li> <li>) Skicon objekte të përmasave dy dhe tri dimensionale.</li> <li>) Realizon hapjen e objektit, apo dy objekteve të ndërfutura tek njeri-tjetri.</li> </ul>
<b>2.Strukturat dhe materialet teknologjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>) Përdor materiale teknologjike kryesore, për realizimin e një produkti të thjeshtë.</li> <li>) Realizon objekte ose produkte të ndryshme gjatë zbatimit të skicave, të modeleve dhe teknikave artizanale, duke përdorur një gamë të gjerë të mjeteve të materialeve dhe veglave të punës.</li> <li>) Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshtë teknologjikë.</li> <li>) Shqyrton një gamë të gjerë të objekteve të jetës së përditshme.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>)] Eksploron se si një varg i formave, i objekteve dhe i strukturave të tjera mund të bëhen duke përdorur një shumëllojshmëri të materialeve me përmirësime të mundshme.</li> </ul>
<b>3. Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>)] Vlerëson veprimtarinë dhe produktin përfundimtar, duke iu referuar planit të veprimit;</li> <li>)] Kryen llogaritje të thjeshta të kostos së materialeve të produktit përfundimtar.</li> <li>)] Përpunon materiale recikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtjeje dhe për ruajtjen e mjedisit.</li> </ul>
<b>4. Teknologjia, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>)] Analizon marrëdhënien e teknologjisë me sistemet teknologjike.</li> <li>)] Mban qëndrim kritik ndaj marrëdhënies së teknologjisë me sistemet teknologjike për ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues.</li> <li>)] Përdor mjete, përmbajtje specifike, programe kompjuterike dhe stimulimet për të mbështetur të nxënit dhe kërkimin e informacionit.</li> <li>)] Sjell shembuj të sistemeve të thjeshta teknologjike dhe i ndan ato në elemente.</li> </ul>

## 7. Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë

Lënda teknologji zhvillohet për 34 javë mësimore me nga 2 orë/javë. Programi specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të gjimnazit. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi në përmbushjen e temave të veçanta, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

- ) Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.
- ) Në program, për secilën tematike, afërsisht **30-35 %** e orëve mësimore totale janë menduar për ndërtimin e njohurive të reja lëndore dhe **65-70 %** e tyre janë menduar për përfortimin e njohurive (gjatë dhe në fund të periudhave shkollore).

Bazuar në këtë kurrikul, lënda “TEKNOLOGJI” synon të përmbushë kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe, që një nxënës duhet t’i zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet tematikave kryesore.



Tabela 3 . Orë të sugjeruara për çdo tematikë

<p><b>TEKNOLOGJIA DHE SISTEMET TEKNOLOGJIKE</b> <b>(8 ORË)</b></p>	<p><b>KOMUNIKIMI GRAFIK –</b> <b>(32 ORË)</b></p>	<p><b>MATERIALET TEKNOLOGJIKE</b> <b>(6 ORË)</b></p>	<p><b>STRUKTURAT DHE MEKANIZMAT</b> <b>(10 ORË)</b></p>	<p><b>TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT</b> <b>(6 ORË)</b></p>	<p><b>TEKNOLOGJIA E SHERBIMEVE</b> <b>(6 ORË)</b></p>
--	---	--	---	--	---

### III. PËRMBAJTJA

Në programin e lëndës teknologji për shkallën e VI-të janë paraqitur tematikat përmbajtësore, të cilat përdoren për të realizuar rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës/lëndës për shkallë të paraqitur në tabelë në fillim të çdo tematike.

**Për secilën tematikë është përcaktuar grupi i njohurive për secilën klasë të shkallës së gjashtë (klasa e 12-të).**

**Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle.**

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore përgjatë vitit shkollor duhet të zhvillohet e ndarë, referuar renditjes sipas tematikave në program. Kombinimi dhe ndarja e koncepteve dhe shprehive, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).

## 1. SHKALLA E GJASHTË KLASA E 12

### 1. Tematika: TEKNOLOGJIA DHE SISTEMET TEKNOLOGJIKE (8 ORË)

#### **Përshkrimi i tematikës:**

“Teknologjia dhe sistemet teknologjike” i ofron nxënësve njohuritë kryesore për teknologjinë dhe sistemet teknologjike, për t’i bërë të aftë të analizojnë marrëdhëniet e tyre si dhe të shoqërisë me teknologjinë dhe mjedisin dhe të përshkruajnë procedura teknologjike të bazuara në problem-zgjidhjen.

#### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:**

Nxënës/i,-ja: analizon se si teknologjia ndihmon në përmirësimin, organizimin dhe zotërimin e mjediseve dhe të proceseve natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit shoqëror dhe individual;

Nxënës/i,-ja: përshkruan teknologjinë si një tërësi sistemesh teknologjike komplekse të përbëra nga inpute, procese, outpute dhe mekanizma fidbeku;

Nxënës/i,-ja: përshkruan ecurinë tipike të projektimit të sistemeve teknologjike si përgjigje/zgjidhje e problemeve teknologjike përkatëse.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<b>NJOHURITË KLASA e 12-të</b>	
<b>Teknologjia, shoqëria, mjedisi</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>J shpjegon kuptimin dhe qëllimin e teknologjisë;</li> <li>J tregon cilat janë llojet dhe etapat e progresit teknologjik;</li> <li>J klasifikon drejtimet kryesore teknologjike të sotme;</li> <li>J përshkruan ndikimin e teknologjisë në transformimet mjedisore, masat për mbrojtjen e këtij mjedisi dhe në zhvillimet e shoqërisë njerëzore;</li> <li>J identifikon mundësitë që ofron teknologjia në plotësimin e dëshirave dhe nevojave personale dhe shoqërore;</li> <li>J tregon se si teknologjia bashkëvepron me shkencat dhe fushat e tjera të veprimtarisë njerëzore, sidomos me matematikën dhe shkencat natyrore;</li> <li>J tregon prirjet e zhvillimit të teknologjisë së të ardhmes.</li> </ul>

<p><b>Sistemet teknologjike</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>)] përshkruan modelin e një sistemi teknologjik tipik dhe elementet kryesore të tij;</li> <li>)] tregon grupet kryesore të inputeve (burimeve) të sistemeve teknologjike;</li> <li>)] analizon procese të ndryshme teknologjike;</li> <li>)] identifikon outputet e sistemeve teknologjike</li> <li>)] jep shembuj të sistemeve të ndryshme teknologjike.</li> </ul>
<p><b>Sistemet teknologjike dhe zgjidhja e problemit teknologjik</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>)] shpjegon kuptimin e koncepteve “problem”, “problem teknologjik” dhe “zgjidhje e një problemi teknologjik”;</li> <li>)] tregon se çfarë përmban projekti (plani) për zgjidhjen e një problemi teknologjik;</li> <li>)] rendit hapat që ndiqen për zgjidhjen e një problemi teknologjik dhe argumenton domosdoshmërinë e secilit prej tyre;</li> <li>)] ndërton skemën e procedurës së zgjidhjes së një problemi teknologjik të thjeshtë.</li> </ul>

### **Qëndrime dhe vlera**

**Realizon dallimin ndërmjet shkencës dhe teknologjisë.**

**Shpjegon rolin dhe veprimin e mekanizmave të fidbekut në sistemet teknologjike.**

**Vecon dhe arrin të zgjidh, me anë të një plan –projekti një problem teknologjik.**

## **2. Tematika: KOMUNIKIMI GRAFIK – (32 ORË)**

### **Përshkrimi i tematikës:**

Komunikimi grafik i njeh nxënësit me mënyrat kryesore të komunikimit grafik, të cilat përbëjnë gjuhën bazë të teknologjisë, duke paraqitur nëpërmjet skicimit, objekte të thjeshta teknike, mendimet dhe idetë e tyre si edhe të lexojnë paraqitje grafike të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare.

### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:**

- J) Analizon lidhjen e komunikimit grafik me disa nga degët kryesore të teknologjisë si: teknologjia e mekanikës, teknologjia e elektricitetit, teknologjia e konfeksioneve, teknologjia e ndërtimit, teknologjia e bujqësisë etj.
- J) Skicon vija të pozicioneve të ndryshme, kënde  $90^0$ ,  $30^0$ ,  $45^0$ ,  $60^0$ , harqe, figurat gjeometrike kryesore si: rreth, elips, gjashtëkëndësh etj..
- J) Zbaton rregullat kryesore të vendosjes së përmasave në leximin dhe kryerjen e skicave dhe vizatimeve.
- J) Realizon ndërtime gjeometrike duke përdorur veglat e vizatimit si:
  - ndarje segmentesh dhe rrathësh në pjesë të barabarta,
  - ndërtime shumëkëndëshash;
  - kalime të rrjedhshme midis dy drejtëzash, drejtëzës dhe rrethit dhe midis dy rrathëve.
- J) Lexon skica dhe vizatime të objekteve të thjeshtë dhe të vështirësisë mesatare.
- J) Lexon vizatimet e planeve të përgjithshme (genplanet) dhe të përcaktojë në to objektet e ndryshme.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p><b>Skicimi dhe njohuri kryesore për komunikimin grafik</b></p> <p>Për të lexuar ose kryer një paraqitje grafike është e nevojshme të zotërohen disa njohuri bazë. Këto njohuri lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>J) materialet dhe mjetet që përdoren për kryerjen e skicave dhe vizatimeve;</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>J) Përdor materialet dhe veglat kryesore që përdoren në kryerjen e skicave dhe vizatimeve: letrat për skica, letrat për vizatime, lapsat që përdoren për skica dhe vizatime, gomat fshirëse, vizoret matëse, trekëndëshat e vizatimit, kompaset etj.;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>J) vija që përdoren në skica dhe vizatime, me rregullat që kanë të bëjnë me skicimin;</li> <li>J) format e shkronjave dhe shifrave që përdoren në skica dhe vizatime;</li> <li>J) rregullat kryesore për vendosjen e përmasave;</li> <li>J) disa ndërtime gjeometrike kryesore që duhen për kryerjen e skicave dhe vizatimeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>J) përdor llojet kryesore të vijave që përdoren në skica dhe vizatime;</li> <li>J) përdor metodën grafike të zmadhimit dhe zvogëlimit të figurave;</li> <li>J) përdor format standarde të shkronjave dhe shifrave në skica dhe vizatime.</li> </ul>
<p><b>Paraqitja e objekteve me anë të projeksioneve kënddrejta</b></p> <p>Paraqitja e objekteve teknike ashtu siç i shohim dhe sidomos paraqitja e elementëve në brendësi të tyre është e vështirë dhe shpeshherë e pamundur. Për këtë arsye në komunikimin grafik përdoret paraqitja e tyre me anën e projeksioneve kënddrejta ose me anën e pamjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>J) njohuritë bazë të paraqitjes me anën e projeksioneve që sqarojnë formën dhe përmasat e objekteve;</li> <li>J) vendosja e përmasave në skica dhe vizatime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>J) Ndërton projeksione kënddrejta të objekteve të thjeshtë;</li> <li>J) përdor shkallët e vizatimit;</li> <li>J) realizon skica të objekteve të thjeshtë;</li> <li>J) lexon skica dhe vizatime të objekteve të thjeshtë dhe të vështirësisë mesatare.</li> </ul>



### **Paraqitjet me prerje**

Paraqitjet me prerje japin mundësi që të tregohet në mënyrë të qartë forma e brendshme e objekteve si dhe të vendosen thjeshtë dhe kuptueshëm përmasat e elementëve brenda objekteve si :

- ) kuptimi gjeometrik i paraqitjeve me prerje;
- ) paraqitja e objekteve me prerje të thjeshta;
- ) rregullat e shënimit të prerjeve;
- ) mënyrat e vijëzimit të tyre dhe vendosja e përmasave në paraqitjet me prerje.

- ) Njeh kuptimin gjeometrik të paraqitjes me prerje;
- ) realizon shënimin e prerjeve sipas standardit të vizatimit;
- ) realizon vijëzimet e sipërfaqeve të prera;
- ) përdor prerjet e thjeshta në paraqitjen e objekteve;
- ) përdor bashkimet e pamjeve me prerjet në skicat dhe vizatime;
- ) lexon skica dhe vizatime të objekteve të thjeshtë dhe të vështirësisë mesatare të paraqitur me prerje.

### **Paraqitjet aksonometrike dhe hapjet e sipërfaqeve**

Paraqitjet **aksonometrike** (trepërmasore) janë paraqitjet më të hershme që janë përdorur në komunikimin grafik. Këto paraqitje janë të ngjashme me pikturën dhe paraqesin objektin ashtu siç shihet në natyrë.

Në këtë temë shpjegohet kuptimi gjeometrik i paraqitjeve aksonometrike dhe njohuritë për paraqitjen në aksonometri të figurave të rrafshëta, të trupave gjeometrikë kryesorë dhe objekteve të thjeshtë vëllimorë.

Kjo temë gjithashtu përmban njohuritë bazë për hapjen e sipërfaqeve të trupave gjeometrikë dhe objekteve të thjeshtë.

- J Njeh kuptimin gjeometrik të paraqitjeve aksonometrike;
- J ndërton me mjetet e vizatimit dhe me dorë të lirë boshtet aksonometrikë për dimetrinë këndngushtë dhe izometrinë kënddrejtë;
- J ndërton paraqitjet aksonometrike të figurave të rrafshëta (katrorit, drejtkëndëshit, trekëndëshit, gjashtëkëndëshit, rrethit);
- J ndërton paraqitjet aksonometrike të trupave gjeometrikë kryesorë dhe objekteve të thjeshtë të dhënë në projektionet kënddrejta ose në natyrë;
- J realizon hapjen e sipërfaqeve të prizmave , piramidave, cilindrave dhe konit të dhënë në projektionet kënddrejta;
- J realizon hapjen e sipërfaqeve të prizmit dhe cilindrit të prerë pjerrtas;
- J bën hapjen e sipërfaqeve të objekteve të thjeshtë të përgatitur prej materialesh në formë fletësh.

<p><b>Vizatimet e ndërtimit</b></p> <p>Do ishte mirë që çdo njeri krahas dokumenteve të tjera të kishte dhe projektin e shtëpisë apo të apartamentit të tij dhe të dinte ta lexonte atë, të kuptonte vendndodhjen, të lexonte projektin arkitektonik dhe atë konstruktiv, të shpjegonte vizatimet e planit të përgjithshëm, vizatimet arkitektonike dhe ato konstruktive;</p> <p>Përvetësimi i këtyre njohurive do bënte të mundur që nxënësit ta njihnin më mirë banesën e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>J Lexon vizatimet e planeve të përgjithshme (genplanet) dhe të përcakton në to objektet e ndryshme;</li> <li>J përcakton e elementet konstruktivë në vizatimet konstruktive të objekteve të ndërtimit;</li> <li>J lexon planet (planimetritë) e objekteve të banimit dhe të përcaktojë elementet e objektit;</li> <li>J lexon planet e mobilimit të objekteve të ndërtimit.</li> </ul>
<p><b>Vizatimet skematike</b></p> <p>Objekte komplekse si objekte banimi, makina, pajisje elektroshtëpiake etj., kanë në përbërjen e tyre elemente të ndryshëm të bashkuar në mënyra të ndryshme për të mundur shërbime të caktuara. Si për shembull në apartamentet tona uji i pijshëm vjen nëpër tuba me përmasa të caktuara, shkon në pajisjet hidrosanitare si boljera, lavapjata, lavamanët etj., të cilat janë vendosur në vendet përkatëse. Kështu ndodh edhe me rrjetin elektrik, telefonik, sinjalin televiziv, internetin etj. Për të mundur realizimin e instalimeve elektrike në një apartament përdoret projekti elektrik, pjesë e të cilit është edhe</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>J Identifikon simbolet e elementëve kryesorë të vizatimeve skematike (skemave elektrike, kinematike dhe hidrosanitare);</li> <li>J skicon skema të thjeshta elektrike, kinematike dhe hidrosanitare;</li> <li>J lexon skema të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare elektrike, kinematike dhe hidrosanitare.</li> </ul>

paraqitja skematike e instalimit. Në këtë linjë jepen njohuri për vizatimet skematike elektrike, skematike kinematike dhe ato hidrosanitare.

### Qëndrime dhe vlera

“Komunikimi grafik” dhe lidhja e tij me teknologjinë, i ndihmon nxënësit të përvetësojnë bazat e leximit dhe interpretimit të paraqitjeve të thjeshta grafike, me të cilat ata ndeshen në shkollë, në jetën e përditshme në punë dhe veprimtari të tjera.

Nxënësit gjithashtu mësohen që të paraqesin qartë dhe saktë nëpërmjet skicimit dhe vizatimit objekte të thjeshta, procese, dukuri, ligjësi dhe rregulla si dhe mendimet e idetë e tyre. Nëpërmjet të mësuarit të komunikimit grafik, nxënësit edukohen estetikisht dhe zhvillojnë veçanërisht të menduarit teknologjik. Përvetësimi i dijeve të komunikim grafik gjithashtu hedh bazat për një angazhim të mundshëm në të ardhmen në sektorë veprimtarie ku komunikimi grafik zë një vend të rëndësishëm. Do ishte mirë që çdo njeri krahas dokumenteve të tjera të kishte dhe projektin e shtëpisë apo të apartamentit të tij dhe të dinte ta lexonte atë. Të dinte të kuptonte vendndodhjen, **të lexonte projektin arkitektonik dhe atë konstruktiv.**

### 3. Tematika: MATERIALET TEKNOLOGJIKE (6 ORË)

**Përshkrimi i tematikës:** *Nëpërmjet kësaj tematike “Materialet teknologjike” nxënësi/sja njihet me kuptimin e konceptit “material teknologjik”, me llojet dhe vetitë teknologjike të grupeve kryesore të materialeve teknologjike, si dhe aftësohet të analizojë përdorimet e materialeve teknologjike në teknologjinë e sotme.*

#### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

- )] klasifikon materialet kryesore teknologjike, tregon vetitë e tyre dhe argumenton rëndësinë e përdorimit të tyre në teknologjinë e sotme dhe të së ardhmes;
- )] përshkruan vetitë kryesore teknologjike të materialeve teknologjike dhe argumenton përdorimet e tyre në teknologji.

#### **Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës**

#### **Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**

#### **Teknologjia dhe materialet teknologjike.**

Nxënësi:

- )] Shpjegon konceptin e materialeve teknologjike;
- )] përshkruan etapat kryesore të zhvillimit të materialeve teknologjike;

	<ul style="list-style-type: none"> <li>) argumenton rëndësinë që kanë materialet teknologjike për teknologjinë dhe zhvillimin ekonomik-shoqëror;</li> <li>) klasifikon materialet teknologjike sipas grupeve kryesore;</li> <li>) përshkruan vetitë teknologjike kryesore të materialeve teknologjike.</li> </ul>
<b>Vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>) Përshkruan vetitë teknologjike të materialeve teknologjike sipas grupeve të ndryshme;</li> <li>) tregon dhe jep shembuj të përdorimit të materialeve teknologjike sipas grupeve të ndryshme;</li> <li>) tregon prirjet kryesore të zhvillimit dhe përdorimit të materialeve teknologjike të së ardhmes.</li> </ul>
<b>Qëndrime dhe vlera</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>) Prezanton raste konkrete të të përdorimit të materialeve teknologjike.</li> <li>) Vlerëson prirjet kryesore të zhvillimit dhe përdorimit të materialeve teknologjike të së ardhmes.</li> <li>) Vlerëson materialet e përdorura, kohën për realizimin e objektit dhe kostot përkatëse sipas planifikimit.</li> <li>) Prezanton shembuj nga jeta e përditshme ku përdoren lloje të ndryshme materialesh teknologjike</li> </ul>	

#### Tematika 4: STRUKTURAT DHE MEKANIZMAT (10 ORË)

**Përshkrimi i tematikës:** “Strukturat dhe mekanizmat: i njeh nxënësit me kuptimin e koncepteve që lidhen me strukturat dhe mekanizmat teknologjike, me klasifikimin e tyre dhe përdorimet e tyre, si dhe i aftëson ata të analizojnë ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave teknologjike të sotme.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- ) Nxënës/i,-ja: tregon kuptimin e strukturave dhe mekanizmave teknologjike, klasifikon këto struktura dhe mekanizma dhe tregon përdorimet e tyre në teknologji.
- ) Nxënës/i,-ja: identifikon strukturat dhe mekanizmat kryesore, përshkruan pjesët përbërëse të tyre dhe shpjegon funksionimin e këtyre strukturave dhe mekanizmave.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

<p><b>Strukturat dhe mekanizmat</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>) Tregon kuptimin e strukturave dhe mekanizmave teknologjike;</li> <li>) përshkruan etapat e zhvillimit të strukturave dhe mekanizmave teknologjike;</li> <li>) argumenton rëndësinë e përdorimit të strukturave dhe mekanizmave në teknologjinë e sotme;</li> <li>) klasifikon strukturat dhe mekanizmat teknologjike kryesore;</li> <li>) dallon strukturat dhe mekanizmat teknologjike kryesore;</li> <li>) tregon rëndësinë dhe përdorimet e strukturave dhe mekanizmave teknologjike kryesore.</li> </ul>
<p><b>Ndërtimi dhe funksionimi i strukturave dhe mekanizmave teknologjike kryesore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>) Identifikon dhe përshkruan pjesët e veçanta (detalet) të strukturave dhe mekanizmave teknologjike;</li> <li>) identifikon dhe përshkruan bashkimet kryesore që përdoren në strukturat dhe mekanizmat teknologjike;</li> <li>) identifikon dhe përshkruan mekanizmat kryesore që përdoren në sistemet dhe strukturat teknologjike;</li> <li>) identifikon dhe përshkruan transmisionet kryesore që përdoren në sistemet dhe strukturat teknologjike;</li> <li>) argumenton dhe jep shembuj të detaleve, bashkimeve, mekanizmave dhe transmisioneve kryesore që përdoren në strukturat teknologjike.</li> </ul>



### Qëndrime dhe vlera

- )] Argumenton me shembuj të detaleve, bashkimeve, mekanizmave dhe transmisioneve kryesore që përdoren në strukturat teknologjike.
- )] Analizon ndikimin që kanë strukturat dhe mekanizmat teknologjike në mënyrën e jetesës në të kaluarën dhe në kohën e sotme
- )] Vlerëson prirjet kryesore të zhvillimit dhe përdorimit të strukturave dhe mekanizmave teknologjike.
- )] Vlerëson materialet e përdorura, kohën për realizimin e objektit dhe kostot përkatëse sipas planifikimit.

## 5. TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT (6 ORË)

**Përshkrimi i tematikës:** “Teknologjia e prodhimit” i njeh nxënësit me kuptimin e konceptit “teknologji prodhimi”, me llojet dhe grupet kryesore, si dhe i aftëson ata të analizojnë përdorimet e teknologjive të prodhimit në shoqërinë e sotme.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

Nxënës/i,-ja tregon kuptimin e “teknologjive të prodhimit”, klasifikon dhe përshkruan këto lloje teknologjish dhe tregon rëndësinë e tyre për shoqërinë e sotme.

Nxënës/i,-ja tregon kuptimin e teknologjisë së prodhimit të energjisë, klasifikon mënyrat kryesore të prodhimit të energjive të llojeve të ndryshme dhe tregon rëndësinë e përdorimit të tyre për shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes.

Nxënës/i,-ja përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit industrial, klasifikon llojet kryesore dhe argumenton rëndësinë dhe përdorimet e tij në shoqëri.

Nxënës/i,-ja përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit artizanal, klasifikon llojet kryesore dhe argumenton rëndësinë dhe përdorimet e tij në shoqëri.

Nxënës/i,-ja përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit bujqësor, klasifikon llojet kryesore dhe argumenton rëndësinë dhe përdorimet e tij në shoqëri.

**Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës**

**Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**

**Sistemet teknologjike të prodhimit**

Nxënësi:

- J Tregon kuptimin e “teknologjisë së prodhimit”;
- J klasifikon dhe përshkruan llojet kryesore të teknologjive të prodhimit;
- J tregon rëndësinë e teknologjisë së prodhimit për shoqërinë e sotme.

**Teknologjia e prodhimit të energjisë**

- J Argumenton rëndësinë e teknologjisë së prodhimit të energjisë për ekonominë dhe shoqërinë;

**Teknologjia e prodhimit industrial**

- ) përshkruan mënyrat dhe teknologjitë kryesore të prodhimit të energjive të llojeve të ndryshme;
  - ) tregon prirjet e teknologjisë së prodhimit të energjisë për shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes.
- 

- ) Përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit industrial;
  - ) klasifikon llojet kryesore të teknologjisë së prodhimit industrial;
  - ) argumenton rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit industrial për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
- 

**Teknologjia e prodhimit artizanal**

- ) Përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit artizanal;
  - ) klasifikon llojet kryesore të teknologjive të prodhimit artizanal;
  - ) argumenton rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit artizanal për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
-

### Teknologjia e prodhimit bujqësor

- ) Përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit bujqësor;
- ) klasifikon llojet kryesore të teknologjisë së prodhimit bujqësor;
- ) argumenton rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit bujqësor për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.

### Qëndrime dhe vlera

- ) Analizon ndikimin e teknologjisë së prodhimit në nivelin dhe mënyrën e jetesës, në vendin tonë dhe në vende të tjera.
- ) Vlerëson prirjet kryesore të zhvillimit të teknologjisë së prodhimit në të ardhmen.

## 6. TEKNOLOGJIA E SHËRBIMEVE (6 ORË)

**Përshkrimi i tematikës:** “Teknologjia e shërbimeve” i njeh nxënësit me kuptimin e konceptit “teknologji shërbimi”, me llojet dhe grupet kryesore, si dhe i aftëson ata të analizojnë përdorimet e teknologjive të shërbimit në shoqërinë e sotme.

Nxënës/i,-ja: përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit, klasifikon llojet kryesore dhe argumenton rëndësinë dhe përdorimet e saj në shoqëri.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

Nxënës/i,-ja përshkruan dhe klasifikon llojet kryesore të teknologjive të shërbimeve dhe vlerëson rëndësinë e tyre për shoqërinë e sotme.

Nxënës/i,-ja përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit, klasifikon llojet kryesore dhe argumenton rëndësinë dhe përdorimet e saj në shoqëri.

Nxënës/i,-ja përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të transportit, klasifikon llojet kryesore dhe argumenton rëndësinë dhe përdorimet e saj në shoqëri.

Nxënës/i,-ja përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit, klasifikon llojet kryesore dhe argumenton rëndësinë dhe përdorimet e saj në shoqëri.

Nxënës/i,-ja përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të turizmit, klasifikon llojet kryesore dhe argumenton rëndësinë dhe përdorimet e saj në shoqëri.

**Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës**

**Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**

<p><b>Sistemet teknologjike të shërbimeve</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>) Tregon kuptimin e “teknologjisë së shërbimit”;</li> <li>) klasifikon dhe përshkruan llojet kryesore të teknologjive të shërbimeve;</li> <li>) tregon rëndësinë e teknologjive të shërbimeve për shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.</li> </ul>
<p><b>Teknologjia e shërbimeve të komunikimit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>) Përshkruan veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit;</li> <li>) klasifikon llojet kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit;</li> <li>) argumenton rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë shërbimeve të komunikimit për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.</li> </ul> <hr/> <ul style="list-style-type: none"> <li>) Tregon kuptimin e “teknologjisë së transportit”;</li> <li>) klasifikon llojet kryesore të teknologjive të transportit;</li> <li>) përshkruan llojet kryesore të teknologjisë së transportit.</li> </ul> <hr/>

<p><b>Teknologjia e shërbimeve të transportit (shpërndarjes)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>) Tregon kuptimin e “teknologjisë së mirëmbajtjes dhe riparimit”;</li> <li>) klasifikon dhe përshkruan llojet kryesore të teknologjive të mirëmbajtjes dhe riparimit.</li> </ul>
<p><b>Teknologjia e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit</b></p>	<hr/> <ul style="list-style-type: none"> <li>) tregon kuptimin e “teknologjisë së shërbimeve turistike”;</li> <li>) klasifikon llojet kryesore të teknologjive që përdoren në shërbimet turistike;</li> <li>) përshkruan llojet kryesore të teknologjive që përdoren në shërbimet turistike;</li> </ul>
<p><b>Teknologjia e shërbimeve turistike</b></p>	

### Qëndrime dhe vlera

- J Vlerëson rëndësinë e teknologjisë së mirëmbajtjes dhe riparimit për shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
- J Vlerëson rëndësinë e teknologjisë së transportit për shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
- J Vlerëson rëndësinë e teknologjisë së komunikimit, si teknologji me rëndësi primare në komunikimin midis njerëzve.
- J Vlerëson rëndësinë e teknologjive të shërbimeve për shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
- J Vlerëson rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë, shërbimeve të komunikimit për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
- J Vlerëson rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë shërbimeve të turistike për shoqërinë e sotme dhe të ardhmes

## IV. Udhëzime metodologjike

Realizimi i programit kërkon përdorimin e metodologjive dhe teknikave që nxisin punën individuale, në grup dhe diskutimin e nxënësve në lidhje me kompetencat e parashtruara për çdo tematikë.

Në qendër të punës së mësuesit duhet të jetë drejtimi i nxënësve për të fituar **aftësi për të eksploruar, planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar veprimtari konkrete teknologjike** në varësi të tematikave të programit

Metodologjitë e mësimdhënies duhet të përmbajnë metoda, strategji dhe teknika që nxisin përdorimin e TIK-ut, nxisin përdorimin e prezantimit nga nxënësit për aftësimin praktik teknologjik.



Mësuesi gjatë shpjegimit të termave dhe demonstrimit të veprimtarive praktike duhet të përdorë sa më shumë njohuritë dhe aftësitë e marra paraprakisht nga nxënësi në lëndë të tjera si dhe të japë shembuj nga realiteti i jetës.

Të mësuarit e lëndës teknologjia, duhet të zhvillohet në përputhje me synimet e kësaj lënde dhe me karakterin e vetë teknologjisë, si fushë e dijes dhe e veprimtarisë njerëzore me prirje të theksuar praktike e krijuese.

Lënda ka si qëllim pajisjen e nxënësve me arsim teknologjik, i cili konsiderohet si pjesë e kulturës së përgjithshme të njeriut. Kjo është mbajtur parasysh gjatë hartimit të programit dhe duhet të mbahet mirë parasysh nga hartuesit e teksteve dhe nga mësuesit që do ta japin lëndën, duke synuar shmangien e karakterit të theksuar profesional të trajtimit të përmbajtjes së materialit mësimor.

Për t'u realizuar objektivat e lëndës teknologjia, kërkohet angazhim mendor, emocional dhe fizik i nxënësve. Kjo arrihet nëpërmjet ndërthurjes së tri fushave të të mësuarit: njohëse, afektive dhe psikomotore.

Fusha **njohëse** ka të bëjë me realizimin e atyre objektive që lidhen me fitimin e kuptimit të njohurive dhe me zhvillimin e shkathtësive e shprehive intelektuale të nxënësve. Për këtë është e nevojshme që gjatë parashtrimit të njohurive nga ana e mësuesit të tërhiqet edhe mendimi i nxënësve, duke shfrytëzuar njohuritë që ata kanë fituar nga lëndët e tjera, nga leximet e pavarura e nga media, si dhe përvojën jetësore vetjake. Por, zhvillimi i të menduarit mund të arrihet në shkallë të lartë kryesisht nëpërmjet aktivizimit të nxënësve në veprimtari praktike dhe eksperimentale, gjatë të cilave përdoren materiale, vegla, aparate e makina të ndryshme.

Fusha **afektive** ka të bëjë me ato objektiva që lidhen me interesat, dëshirat, qëndrimet, vlerat dhe emocionet e nxënësve. Edhe në këtë fushë ndikon fuqishëm angazhimi i nxënësve në veprimtari praktike, gjatë të cilave ata gjejnë mundësi të shfaqin origjinalitetin e tyre në drejtim të

parashtrimin të mendimeve, përballimit të vështirësive, shfrytëzimit të vlerave vetjake, të provuarit të emocioneve të ndryshme gjatë realizimit të veprimtarisë etj..

Fusha **psikomotore** ka të bëjë me realizimin e atyre objektivave që lidhen me formimin dhe zhvillimin e shkathtësive dhe shprehive lëvizore të nxënësve, gjë që arrihet nëpërmjet angazhimit të tyre në veprimtari praktike. Megjithatë, duhet thënë se zhvillimi psikomotor nuk është synim parësor në të mësuarit e teknologjisë, prandaj veprimtaria praktike e nxënësve shihet më tepër si një rrugë e rëndësishme për zhvillimin njohës dhe afektiv se sa psikomotor të tyre.

Të mësuarit e teknologjisë sipas këtij konceptimi përputhet me natyrën e vetë teknologjisë si fushë dijesh e veprimtarie. Ai nuk mund të bëhet thjesht në një mjedis akademik, por kërkon mundësisht ngritjen e kabineteve e laboratorëve të posaçëm, të cilat gradualisht të plotësohen me pajisje për të siguruar aktivizimin e mësuesve dhe sidomos të nxënësve gjatë gjithë trajtimit të lëndës. Njëkohësisht, mund dhe duhet të shfrytëzohen edhe kabinetet e laboratorët që ka shkolla për lëndët e tjera, veçanërisht ato të shkencave natyrore. Kjo do të ndihmonte për shfrytëzimin në teknologji të koncepteve dhe të shkathtësive të fituara në lëndë të tjera, shikimin e këtyre lëndëve nga nxënësit si pjesë të një të tërë të madhe dhe jo si njësi të veçanta.

Mësuesit e teknologjisë duhet të përdorin një larmi të madhe **strategjish mësimore**, në mënyrë që të arrihet aktivizimi maksimal i nxënësve jo vetëm brenda orës së mësimin, por edhe gjatë përgatitjes së tyre jashtë mjediseve të shkollës

## V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së mësimi bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqëndrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anë të dobëta dhe anë të forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive teknologjike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*psh. vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, test objektiv, vëzhgim me një listë të plotë treguesish, portofol, prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj.*) Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve duhen pasur parasysh:

- ) përcaktimi i qëllimit dhe i strategjisë së vlerësimit;
- ) përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- ) përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- ) dallimi qartë i qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim;
- ) vlerësimi u adresohet njohurive, shprehive e aftësive;
- ) reflekton besimin që të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;
- ) informacioni për rezultatet e vlerësimit duhet të motivojë nxënësin, të ndikojë që nxënësi të pranojë se gabimi është pjesë e të nxënës dhe të ndihmojë progresin e mëtejshëm;
- ) vlerësimi duhet të konsiderohet si pjesë e procesit mësimdhënie-nxënie dhe jo si veprimtari më vete;
- ) vlerësimi ndihmon nxënësit të marrin përgjegjësi për veten e tyre, duke përfshirë strategji të vetëvlerësimit, të vlerësimit të shokut me shokun;
- ) vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës në kuptimin që t'u sigurojë të gjithë nxënësve të demonstrojnë arritjet e tyre dhe të arrijnë më të mirën e mundshme.

Vlerësimi si proces lidhet me tërësinë e metodave, praktikave dhe teknikave që përdorin mësuesit për të testuar, për të kontrolluar, analizuar dhe për të matur nivelin e njohurive, aftësive dhe të performancës së nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë i realizueshëm, i vlefshëm, korrekt, i besueshëm dhe i saktë.

Vlerësimi duhet të japë një pasqyrë për arritjet e nxënësit, si edhe vështirësitë që mund të kenë nxënësit gjatë realizimit të detyrave ose projekteve kurrikulare. Të vlerësosh nxënësit nuk do të thotë vetëm t'i vendosësh atij një notë, por edhe ta ndihmosh atë të kalojë vështirësitë gjatë arritjes së kompetencave. Vlerësimi në klasë luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si mësojnë nxënësit, në motivimin e tyre për të nxënë dhe në mënyrën e shpjegimit të mësuesit. Pyetjet që lidhen me cilësinë (besueshmërinë, burimet e referencës, vlefshmërinë) janë të rëndësishme për të gjitha llojet e vlerësimit në klasë.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të ndihmohen nxënësit të bëhen autonomë dhe të jenë në gjendje të vetëvlerësojnë progresin e tyre.

Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësit kanë përvetësuar dhe janë të aftë të bëjnë. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Mësuesit nuk e kanë të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Në paragrafin në vijim do të gjeni disa forma vlerësimi të cilat ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë vështirësitë e tyre.

#### **a. Vlerësimi formues**

Ky lloj vlerësimi duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga mësuesi/ja, në mënyrë që të kuptohen vështirësitë e nxënësve, më pas të shihet ecuria e tyre dhe në fund të kapitullit të shihet nëse janë arritur kompetencat e kërkuara. Për nxënësit e ciklit të mesëm të ulët, ky vlerësim është shumë i rëndësishëm pasi ata fillojnë të analizojnë në mënyrë të thelluar atë çfarë ata janë në gjendje të arrijnë dhe ta përdorin si pikën e tyre të fortë. Gjatë këtij vlerësimi, mësuesi/ja duhet të vëzhgojë herë pas here nxënësit, të realizojë bashkëbisedime me ta, të realizojë produkte të ndërmjetme para produkteve finale. Ky lloj vlerësimi i ndihmon nxënësit të gjejnë mënyrën e duhur për të mësuarin efektiv.

#### **b. Vlerësimi nëpërmjet portofolit**

Një formë tjetër vlerësimi është edhe *vlerësimi nëpërmjet portofolit*, është një formë që e ndihmon nxënësin të shohë se si ai avancohet hap pas hapi. Portofoli i nxënësit është një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, i cili përmban një koleksion punimesh që ai organizon përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra shtëpie me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi/ja është në rolin e atij që drejton dhe rekomandon. Qëllimi kryesor i portofolit është që nxënësi/ja të koleksionojë ato dokumente që atij mund t'i shërbejnë në vitet në vijim. Gjithashtu, në portofol, nxënësi/ja mund të shohë se si ai/ajo përparon nga muaji në muaj ose nga semestri në semestër.

### **c. Vetëvlerësimi**

Ku lloji vlerësimi është gjykimi që secili nxënës jep për arritjet e tij. Vetëvlerësimi shpesh shërben si një plotësues i domosdoshëm i teknikave të vlerësimit, të bëra nga mësuesi/ja dhe nga provimet. Pika e fortë e vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është një faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxëniet e tyre. Duhet theksuar që vetëvlerësimi është më i vlefshëm dhe më objektiv nëse nxënësit i jepen kritere të sakta mbi të cilat ai/ajo bën vetëvlerësimin e punës së tij/saj. *P.sh.: mund t'i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetëkorrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta dhe, më pas, ai/ajo ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar.*

Vlerësimi i nxënësit mund të bëhet në mënyrë individuale ose në grup. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim apo nëpërmjet veprimtarive të tjera.

Nxënësi vlerësohet për portofolin e detyrave, për prezantimet, vëzhgimet e realizuara në përputhje me detyrat standarde të përcaktuara nga mësuesi.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi duhet t'u parashtrorë nxënësve qëllimin, kriteret dhe instrumentet e vlerësimit.

Çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të nxënësve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.

## **VI. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE**

Për arritjen me sukses të kompetencave në fushën e TIK-ut dhe teknologjisë është e rëndësishme të përdoren materiale dhe burime mësimore që japin një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi, shkathtësi, njohuri dhe qëndrime që u nevojiten atyre për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Një nga burimet e thjeshta mësimore dhe që përdoret shpesh nga nxënësit dhe mësuesit është teksti mësimor. Mirëpo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të shtimit të informacionit digjital, mësuesi duhet ta shohë tekstin më tepër si një burim nxitës, por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe tek nxënësit.

Mësuesit mund të bashkëpunojnë online me mësues të shkollave të tjera për të gjetur burime të besueshme informacioni, që u vijnë në ndihmë jo vetëm nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre, por edhe mësuesve për të zhvilluar një qasje të re metodike. Nëpërmjet rritjes së shumëllojshmërisë së burimeve në nxësim më shumë nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, krijues dhe problemzgjdhës gjatë procesit mësimor.

Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore mund të jenë: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërgjegjësuese, enciklopeditë, softëra elektronike në funksion të mësimdhënies/mësimnxënies, studimet shkencore me fokus tek teknologjia dhe TIK-u, etj...

Gjithashtu në bashkëpunim me nxënësit dhe shkollat mund të organizohen seminare të ndryshme mësimore dhe punimet më të mira të publikohen dhe t'u vihen në dispozicion të gjitha shkollave. Në ditët e sotme, ndodh shpesh që nxënësi të jetë një hap përpara mësuesit për sa i përket informacioneve elektronike, në këtë mënyrë mësuesit mund të krijojnë forume mësimore bashkë me nxënësit për të krijuar materiale në ndihmë të procesit mësimor.

Koordinator programi :

[edlirasina@yahoo.com](mailto:edlirasina@yahoo.com)

0697428131